

HAJDE TE KHELAS

Konkurs Kërcimi ERIAC

për të Rikrijuar dhe Promovuar Trashëgiminë e Kërcimit Rom

APLIKIMI I HAPUR

Hajde Te Khelas - ERIAC Konkurs Kërcimi thërret të gjithë ekspertët Rom të kërcimit, artit të lëvizjes dhe koreografisë, të cilët performojnë vetëm, në çifte ose në grupe më të mëdha nga e gjithë bota, për të paraqitur virtuozeitetin dhe larminë e trashëgimisë së kërcimit Rom, të kaluar brez pas brezi, duke aplikuar me një video të shkurtër kërcimi.

Hajde Te Khelas është një konkurs kërcimi i bazuar në meritë i cili merr parasysh kriteret e mëposhtme:

- rivendosja e lëvizjeve dhe formave tradicionale të kërcimit;
- virtuozeiteti i lëvizjeve dhe shprehja e emocioneve përmes kërcimit;
- qëllimin e koreografisë dhe prezantimit;
- origjinalitetin e lëvizjeve të traditave të caktuara rajonale;
- rindërtimi i trashëgimisë së kërcimit Rom në artin e kërcimit bashkëkohor dhe lëvizjes.

Na dërgoni videon tuaj të shkurtër dhe **FITO** një nga çmimet ndërsa festoni traditat e larmishme të kërcimit Rom përmes **Hajde Te Khelas - ERIAC Dance Contest!**

Juria me ekspertë ndërkombëtarë zgjedh 10 fitues:

1ri - 1500€
2ti - 1000€
3ti - 700€

7 finalistët e tjerë të mbetur do të marrin një dhurim prej **250€**.

Videoja me më shumë shikime në Facebook merr **Çmimin e Audiencës** me një dhurim prej **1000€!**

SI TË APLIKONI?

Ju lutem lexoni udhëzimet me kujdes

- Videoja duhet të jetë **maximumi 2** minuta e gjatë;
- Kërceni vetëm, me shoqërinë ose me familjen tuaj;
- Secili performues mund të aplikojë vetëm një herë (me një video);
- Videoja duhet të jetë e regjistruar pas publikimit të kësaj thirrjeje (pas 8 Qershorit);
- Videot do të ngarkohen në kanalën e Facebook-ut të ERIAC. Shpërndaj dhe pëlqej videon për të marrë çmimin e audiencës!
- Me mirësi kërkohet video origjinale
- Videot me çështje të drejtave të autorit në muzikë mund të bëhen mute automatikisht nga Facebook, por prap do të qëndrojnë pjesë e konkursit

Dërgoni tek ERIAC regjistrimin video tuaj të kërcimit në një kanalet e mëposhtme

- Facebook messenger tek European Roma Institute for Arts and Culture ERIAC
- Email me subject "HAJDE TE KHELAS " (eriac@eriac.org)
- WeTransfer (eriac@eriac.org)

Mënyra të tjera të dërguarit nuk janë të pranueshme.

Videot duhet të dërgohen deri në 30 Qershor 2020, 18:00 CET

FORMATI I SKEDARIT: Dërgoni një skedar origjinal (MP4 or MOV), youtube ekzistues ose lidhje të tjera nuk janë të pranueshme.¹

Informacioni i mëposhtëm duhet të jetë i bashkëngjitur me videon tuaj:

- Emri i/e artistit/artistes ose grupit të kërcimit
- Adresa juaj e email-it
- Qyteti dhe shteti rezident
- Lloji/stili i kërcimit
- Informacionin që ju keni rreth origjinës ose traditës me kërcimin tuaj performues

KUSH DO TË GJYKOJË?

Juria me ekspertë ndërkombëtarë do të vendosë për çmimet

Emrat e anëtarëve të jurisë:

- Isaac Blake (vallëtar, koreograf, Drejtore Ekzekutive e Kompanisë Kulturë dhe Arte Rome në Cardiff)
- Rosamaria Kostic Cisneros (vallëtare, kërcimtare historiane and kritike, fellow hulumtues tek Universiteti Coventry për Hulumtim Vallëzues)
- Belen Maya (vallëtare e flamenkos Spanjoll, koreografe and edukatore)
- Sani Rifati (drummer, këngëtar, kërcimtar dhe instruktor kërcimi)
- Toby Gorniak (kërcimtar, Bashkëthemelues-CEO i Street Factory)
- Attila Szanto (koreograf, vallëtar dhe lider i RomaFest Rumun)

Juria do të vendosë për fituesit në bazë të:

- Virtuozitetit në vallëzim tradicional ose bashkëkohor
- Kreativitetit
- Koordinimit
- Ritmit
- Origjinalitetit
- Demonstrimit të trashëgimisë dhe talentit të vallëzimit Rom

AFATI

Videot mund të dërgohen nga 8 Qershori deri në **30 Qershor, 2020, 18:00h CET**. Ju lutem kini parasysh se videot e paraqitura pas këtij afati do të pranohen.

Fituesit do të shpallen në **20 Korrik, 2020** dhe dhurimet do të jepen (transferohen) në fillim të Gushtit!

¹ Duke marrë pjesë në konkursin online, ju pranoni që ERIAC do të ruajë detajet e kontaktit tuaj për të siguruar informacione ose mundësi të mëtejshme. ERIAC nuk do t'i kalojë të dhënat tuaja palëve të treta.